

---

## Permbajtja

---

Raporti i audituesit te pavarur	i-ii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e te ardhurave	2
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
1 Informacion i pergjithshem	5
2 Baza e pergatitjes	5
3 Permbledhje e politikave kontabel	6
4 Percaktimi i vleres se drejte	10
5 Manaxhimin i riskut financiar	10
6 Aktive afatgjata materiale	12
7 Kliente dhe te tjera kerkesa per arketim	13
8 Parapagimet dhe te ardhurat e shtyra	13
9 Mjete Monetare dhe ekuivalente me to:	13
10 Kapitali aksioner	13
11 Furnitore dhe detyrime te tjera	14
12 Te ardhurat	14
13 Kosto per kryerjen e sherbimeve	15
14 Shpenzime personeli	15
15 Shpenzimet te pergjithshme dhe administrative	15
16 Te ardhura te tjera	16
17 Tatimi mbi fitimin	16
18 Instrumentat Financiare	17
19 Palet e lidhura	19
20 Ngjarjet pas dates te raportimit	20

**Optimum Media Sh.A.**

**Pasqyrat financiare  
per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013  
(dhe raporti i audituesit te pavarur)**



## BAKER TILLY ALBANIA

Rr. Themistokli Gërmenji,  
No. 2, Ambasador 1,  
3rd floor, Tirana, Albania  
Tel: +355 4 223 2726  
[www.bakertillyalbania.com](http://www.bakertillyalbania.com)

### **RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR**

#### **Raport mbi Pasqyrat Financiare**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Optimum Media sha, që përfshijnë pasqyrën e gjëndjes financiare më 31 Dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabile dhe shënime të tjera shpjeguese.

#### **Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësira; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat.

#### **Përgjegjësia e Audituesit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin procedurë për të marrë evidencë auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

## Opinion

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të Optimum Media sha. paraqesin në mënyrë të sinqertë në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të shoqërisë më 31 Dhjetor 2013, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Baker Tilly Albania shpk.

Elton Haxhi  
Ekspert Kontabël i Regjistruar



Tiranë  
28 Mars 2014

# Optimum Media Sh.A.

## Pasqyra e pozicionit financiar

me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

	Shenime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<b>Aktive</b>			
Aktive afatgjata materiale	6	2.131.318	2.330.120
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>2.131.318</b>	<b>2.330.120</b>
Kliente dhe te tjera kerkesa per arketim	7	201.694.003	176.670.039
Parapagime	8	12.309.440	13.701.380
Tatim fitimi i parapaguar		1.405.422	1.115.496
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	9	12.444.515	22.012.992
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>227.853.380</b>	<b>213.499.907</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>229.984.698</b>	<b>215.830.027</b>
<b>Kapitalet e veta</b>			
Kapitali themeltar	10	3.500.000	2.000.000
Rezerva ligjore		200.000	200.000
Fitime te mbartura		1.469.848	1.162.006
<b>Totali i kapitaleve te veta</b>		<b>5.169.848</b>	<b>3.362.006</b>
<b>Detyrime</b>			
Furnitore dhe detyrime te tjera	11	212.505.410	198.766.641
Te ardhura te shtyra	8	12.309.440	13.701.380
Tatimi aktual i pagueshem		-	-
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>224.814.850</b>	<b>212.468.021</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitaleve te veta</b>		<b>229.984.698</b>	<b>215.830.027</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 20 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.



# Optimum Media Sh.A.


## Pasqyra e te ardhurave

per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

	Shenime	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Te ardhurat	12	656.922.339	809.175.847
Kosto per kryerjen e sherbimeve	13	(627.231.588)	(774.724.914)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>29.690.751</b>	<b>34.450.933</b>
Shpenzime per personelin	14	(22.657.111)	(21.176.100)
Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	15	(4.997.859)	(11.265.931)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	(542.474)	(660.134)
<b>Rezultati nga veprimtarite shfrytezuese</b>		<b>1.493.307</b>	<b>1.348.768</b>
Te ardhura te tjera	16	148.783	-
Te ardhura/(shpenzime) financiare		(9.315)	239.119
		139.468	139.468
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>1.632.775</b>	<b>1.587.887</b>
Tatimi mbi fitimin	17	(162.927)	(425.881)
<b>Fitimi neto per periudhen</b>		<b>1.469.848</b>	<b>1.162.006</b>

Pasqyra e te ardhurave duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 20 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

 2

## Optimum Media Sh.A.


### Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

	<b>Kapitali themeltar</b>	<b>Rezerva ligjore</b>	<b>Fitime te mbartura</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja me 1 Janar 2012</b>	<b>2.000.000</b>	<b>128.104</b>	<b>1.804.453</b>	<b>3.932.557</b>
Fitimi i vitit	-	-	1.162.006	1.162.006
Dividende te paguar	-	-	(1.732.557)	(1.732.557)
Rezerva ligjore	-	71.896	(71.896)	-
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2012</b>	<b>2.000.000</b>	<b>200.000</b>	<b>1.162.006</b>	<b>3.362.006</b>
Fitimi i vitit	-	-	1.469.848	1.469.848
Kapitali themeltar	1.500.000	-	(1.162.006)	337.994
<b>Gjendja me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>3.500.000</b>	<b>200.000</b>	<b>1.469.848</b>	<b>5.169.848</b>

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 20 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

 3

# Optimum Media Sh.A.

## Pasqyra e flukseve monetare

per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

Shenime	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
<b>Flukse monetare nga veprimtari shfrytëzuese:</b>		
Fitimi neto i vitit	1.469.848	1.162.006
<i>Rregullime per:</i>		
Amortizimin 6	542.474	660.134
Tatimi mbi fitimin	162.927	425.881
Fitimi nga veprimtarite shfrytëzuese para ndryshimeve ne kapitalin punues	<b>2.175.249</b>	<b>2.348.597</b>
Rritja e kerkesave per arketim	(23.632.024)	(701.287)
Rritja ne inventar	-	224.800
Rritja e llogarive te pagueshme	12.346.829	16.367.719
	<b>(9.109.946)</b>	<b>18.139.253</b>
Tatim fitimi i paguar	(452.853)	(1.583.464)
<b>Mjete monetare neto nga veprimtarite e shfrytëzimit</b>	<b>(9.562.799)</b>	<b>16.555.789</b>
<b>Flukse monetare nga veprimtarite investuese</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale 6	(343.672)	(33.600)
<b>Mjete monetare perdorur ne veprimtarite investuese</b>	<b>(343.672)</b>	<b>(33.600)</b>
<b>Flukse monetare nga veprimtarite financuese</b>		
Rritje kapitali	337.994	-
Dividende te paguar	-	(1.732.557)
<b>Mjete monetare perdorur ne veprimtarite financuese</b>	<b>337.994</b>	<b>(1.732.557)</b>
<b>Rritja neto e mjeteve monetare</b>	<b>(9.568.477)</b>	<b>14.789.632</b>
Mjete monetare ne fillim te vitit	22.012.992	7.223.360
<b>Mjete monetare ne fund te vitit</b>	<b>12.444.515</b>	<b>22.012.992</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 20 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare jane pergatitur nga dhe miratuar ne 27 Mars 2014 nga:

Pergatiti:  
Suzana Dedja  
Financiere

Miratoi:  
Vilma Maze  
Administratore

**Optimum Media SH.A**  
Rr. Themistokli Gërmenji, Nr. 1  
Tiranë  
NUI: K815040691  
Tel: +355 4 2322578



# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

---

### 1 Informacion i pergjithshem

Optimum Media Sh.A ("Shoqeria") u themelua me 28 Shkurt 2008 (data e themelimit) me aktivitet primar sherbimin e reklamave. Shoqeria eshte filial i DDB Albania Sh.A. dhe rrjedhimisht filial i Omnicom Group Inc. SHBA.

Fillimisht DDB Albania Sha ka qene ortak i vetem i ketij filiali. Kapitali i Shoqerise Optimum Media eshte 2.000.000 Lek i ndare ne 2.000 aksione me 1.000 Lek secili. Gjate vitit 2010, 660 aksione i jane transferuar me vlere nominale Znj.Vilma Maze dhe me 31 Dhjetor 2013 DDB Albania ka nje pjesemarrje prej 67% (2012: 67%) dhe Znj.Vilma Maze 33% (2012: 33%) te kapitalit.

Zyra e regjistrimit te Shoqerise eshte ne Tirane, Rr. Rruga Themistokli Germenji, nr.1.

Kapitali aksioner eshte rritur ne vitin 2013 me 3.500.000 Lek pjeserisht me fitime te mbartura dhe pjeserisht me kontribut nga aksioneret ne perpjestim me pjesmarrjen e tyre ne kapital.

Shoqeria me 31 Dhjetor 2013 punesonte 9 punonjes (2012: 9 punonjes).

Pasqyrat financiare te shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane miratuar nga Administratorja ne 27 Mars 2014.

### 2 Baza e pergatitjes

Pasqyrat financiare individuale jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK). te aplikueshme per pasqyrat financiare qe mbulojne periudhat duke filluar nga 1 Janar 2009. Keto jane pasqyrat e para financiare te pergatitura bazuar ne SKK dhe SKK 1 "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare" eshte aplikuar.

#### (a) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

#### (b) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten ne Lek. e cila eshte monedha funksionale per Shoqerine.

#### (c) Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SKK kerkon qe drejtimi te kryeje gjykime. çmuarje dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave dhe shumave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve. te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto çmuarje. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne periudhat e ardhme nese ato ndikohen. Ne veçanti. informacion mbi elemente te rendesishem ne vleresimin e pasigurive dhe gjykime kritike per aplikimin e politikave kontabel qe kane efekt material ne vlerat kontabel ne pasqyrat financiare jepet ne shenimin 17 Instrumentet Financiare – Risku i Kredise.



5

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 3 Permbledhje e politikave kontabel

#### (a) Aktive afatgjata materiale

##### (i) Njohja dhe matja

Zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih me poshte) dhe humbjet e akumuluar nga zhvleresimi (shih politiken kontabel (d)).

Kosto perfshin shpenzime qe jane drejtperdrejt te ngarkueshme per blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve te ndertuara nga vete shoqeria perfshin koston e materialeve dhe te fuqise punetore, si dhe ndonje kosto tjeter qe lidhet drejtperdrejt me venien e aktivitetit ne vendin dhe kushtet e nevojshme qe ai te jete i perdorshem ne menyren e synuar nga drejtimi dhe kosto te kapitalizuara te huamarrjes.

Kur pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesine e dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si elemente te vecanta te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja nga shitja e nje aktiviteti afatgjate material percaktohet duke krahasuar arketimet nga shitja me vleren kontabel te aktivitetit afatgjate material, dhe njihet neto ne te ardhura/shpenzime te tjera ne fitim ose humbje.

##### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje elementi te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren mbartur te elementit nese eshte e mundshme qe perfitime ekonomike ne te ardhmen qe i atribuohen atij elementi do te rrjedhin ne shoqeri, dhe kostoja e tij mund te matet me besueshmeri. Kostot e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihen ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi njihet ne fitim ose humbje me metoden e zvogelimit te teprices. Metodet e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nese nuk eshte e pakonsiderueshme) jane rivleresuar ne daten e raportimit.

Me poshte jane normat e amortizimit te aplikuar:

- |                       |     |
|-----------------------|-----|
| • Pajisje informatike | 25% |
| • Pajisje zyre        | 20% |
| • Te tjera            | 20% |

#### (b) Instrumentat financiare

Shoqeria mban vetem instrumente financiare jo-derivative

##### (i) Aktivitetet financiare jo-derivative

Shoqeria njej fillimisht llogarite e arketueshme ne daten kur ato lindin. Te gjithet aktivitetet e tjera financiare njihen fillimisht ne daten e transaksionit, e cila eshte data kur Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.

Shoqeria nuk e njej me nje aktiv financiar kur te drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare qe rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojne, ose kur Shoqeria i transferon aktivitetin financiar nje pale tjetere, pa mbajtur kontrollin ose te gjitha risqet dhe perfitimet e aktivitetit. Interesi i aktiveve financiare te transferuara qe eshte krijuar ose mbajtur nga Shoqeria njihet si nje aktiv ose detyrim i vecante.

 6

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (b) Instrumentet financiare (vazhdim)

##### (i) Aktivet financiare jo-derivative (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet ne pasqyren e pozicionit financiar atehere dhe vetem atehere kur Shoqeria ka nje te drejte ligjore te netoje vlerat dhe ka per qellim te shlyhet ne baze neto ose te arketoje aktivin dhe paguaje detyrimin njekohesisht.

Shoqeria zoteron aktive financiare jo-derivative si me poshte: mjete monetare dhe ekuivalente me to; kerkesa per arketim.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to perfshijne vlerat ne arke dhe llogari rrjedhese ne banka, me maturitet origjinal tre muaj ose me pak, dhe mbahen me koston e amortizuar.

Kerkesat per arketim njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vijim me kosto te pakesuara per humbjet per zhvleresime.

Kerkesat per arketim njihen fillimisht me vleren e drejte plus koston e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejt me pervetesimin e tyre dhe ne vijim maten me kosto te amortizuar pakësuar për humbjet për zhvlerësime

##### (ii) Detyrimet financiare jo-derivative

Detyrimet financiare njihen fillimisht ne daten e transaksionit, e cila eshte data kur Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit.

Shoqëria nuk e njeht me një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të Shoqërisë janë shlyer ose janë anuluar.

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto paraqitet ne pasqyren e pozicionit financiar atehere dhe vetem atehere kur Shoqeria ka nje te drejte ligjore te netoje vlerat dhe ka per qellim te shlyhet ne baze neto ose te arketoje aktivin dhe paguaje detyrimin njekohesisht.

Detyrimet financiare jo-derivative perbehen nga detyrimet ndaj paleve te lidhura dhe llogari te pagueshme. Keto detyrime financiare njihen fillimisht me vleren e drejte plus koston e transaksionit qe jane te lidhura drejtperdrejt me pervetesimin e tyre, dhe ne vijim maten me kosto te amortizuar.

##### (iii) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Shoqerise njihet me vleren nominale

#### (c) Zhvleresimi

##### (i) Aktivet financiare jo-derivative

Nje aktiv financiar qe nuk mbahet me vleren e drejte permes fitim humbjes vleresohet ne cdo date raportimi per te percaktuar nese ka evidencë objektive qe ai është zhvlerësuar. Nje aktiv financiar është zhvlerësuar nese evidencë objektive tregon se nje ngjarje zhvleresimi ka ndodhur pas njohjes fillestare te aktivitet, dhe qe ngjarja e zhvleresimit ka nje ndikim negativ ne flukset e ardhshme te mjeteve monetare te aktivitet, te cilat mund te maten me besueshmëri.

Evidenca objektive qe aktivet financiare jane te zhvleresuara mund te perfshijë mospagesa ose veshtiresi financiare te debitorëve, ristrukturimin e nje shume me kushte dhe afate te cilat Shoqeria nuk do t'i kishte

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

---

### 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (c) Zhvleresimi (vazhdim)

##### (i) Aktivet financiare jo-derivative (vazhdim)

dhënë ndryshe, të dhëna që një debitor po falimenton, ndryshime të pafavorshme në aftësitë paguese të huamarrësve të Shoqërisë.

Shoqëria konsideron evidencën e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme të cilat janë individualisht të rëndësishme vlerësohen individualisht për zhvlerësim specifik. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të rëndësishme që rezultojnë të mos jenë individualisht të zhvlerësuara vlerësohen më pas në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur por nuk është identifikuar ende. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen në mënyrë kolektive duke grupuar së bashku llogaritë e arkëtueshme që kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

Për vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor modele statistikore të përvojës historike të humbjes, periudhën e rimarrjes dhe vlerën e humbjes, duke përfshirë dhe gjykimin e drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditimit janë të tilla që humbjet aktuale të ketë gjasa të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimi historik.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt llogarive të arkëtueshme. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen. Kur një ngjarje pas datës së raportimit (p.sh. pagesa nga një debitor) tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zvogëlimi i zhvlerësimit anulohet nëpërmjet fitimit ose humbjes.


##### (ii) Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është me e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të pasasë dhe risqet specifike për aktivin ose njësinë gjeneruese të mjeteve monetare. Për qellime të rishikimit për zhvlerësim, aktivet që nuk mund të testohen individualisht grupohen së bashku në grupin me të vogël të aktiveve që gjenerojnë mjete monetare nga përdorimi i vazhdueshëm të cilat janë të pavarura nga flukset monetare të aktiveve të tjera.

#### (d) Njohja e te ardhurave

E ardhura nga kryerja e shërbimeve njihet në fitim ose humbje kur shërbimi kryhet.



# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (e) Perfitimet e punonjesve

*Sigurimet shoqerore te detyrueshme*

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Qeveria Shqiptare eshte pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Shoqerise ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.

*Leje vjetore te paguara*

Shoqeria njej si detyrim vleren e paskontuar te kostove te vleresuara ne lidhje me lejet vjetore qe pritet te paguhen ne kembim per sherbimin e punonjesve gjate periudhes.

#### (f) Shpenzimet

*Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

*Shpenzimet e qirase*

Shpenzimet e qirase se zakonshme jane ngarkuar ne fitim ose humbje ne menyre lineare gjate periudhes se qirase. Pagesa motivimi marre nga qiradhenesi jane njohur si pjese perberese e shpenzimit total te qirase pergjate periudhes se qirase.

#### (g) Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi nga llogarite ne banka dhe fitimet nga kursi i kembimit qe njihen ne fitim ose humbje. Te ardhurat nga interesi njihen kur ai perfitohet duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit per huate dhe humbjet nga kursi i kembimit. Te gjitha kostot e huave njihen ne fitim ose humbje duke perdorur metoden e interesit efektiv.

#### (h) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes aktuale dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje, pervec pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera permbledhese.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet ose te arketohet mbi fitimin ose humbjen e tatueshme te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe hyn ne fuqi menjehere ne daten e raportimit, dhe cdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre eshte njohur ne lidhje me diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe bazes tatimore. Shuma e tatimit te shtyre eshte llogaritur bazuar ne metoden e realizimit ose kompensimit te vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur shkalle tatimore qe jane ne fuqi ose qe hyjne ne fuqi menjehere ne daten e raportimit.

Aktivet dhe pasivet tatimore te shtyra netohen nese ekziston nje e drejte ligjore per te netuar detyrimet per tatimin aktual te pagueshem ndaj tatimit te parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi te ardhurat qe percakton i njejti autoritet tatimor mbi te njejtin subjekt tatimpagues.

*Ming*<sup>9</sup>

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 3 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

#### (h) Tatim fitimi (vazhdim)

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktivit tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

#### (i) Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e dates se raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i kembimit per zerat monetare eshte diferenca ndermjet kostove te amortizuara ne monedhen funksionale ne fillim te periudhes, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjate periudhes, dhe kostove te amortizuara ne monedhe te huaj te konvertuara me kursin e kembimit ne fund te periudhes. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj qe maten me vlere te drejte konvertohen ne monedhe funksionale me kursin e kembimit ne daten kur eshte vendosur vlere e drejte. Diferencat nga kursi i kembimit qe rrjedhin nga konvertimi njihen ne fitim ose humbje, pervec diferencave qe rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve te kapitalit te vlefshme per shitje (nese ka).

### 4 Percaktimi i vleres se drejte

Vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare eshte perafersisht e barabarte me vleren kontabel per shkak te maturitetit te tyre te shkurter.

### 5 Manaxhimin i riskut financiar

Shoqeria eshte ekspozuar ndaj rreziqeve te meposhtme nga perdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredise
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shenim paraqet informacion rreth ekspozimit te Shoqerise ndaj secilit prej rreziqeve te mesiperm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqerise per matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shenime te metejshme sasiore jane te perfshira ne keto pasqyra financiare.

#### *Politika e manaxhimit te riskut*

Bordi i Drejtoreve mbart pergjegjesine e pergjithshme per vendosjen dhe mbikeqyrjen e politikave te Shoqerise per menaxhimin e riskut.

Politikat e menaxhimit te riskut te Shoqerise jane vendosur per te identifikuar dhe analizuar rreziqet qe perball Shoqeri, per te vendosur limitet dhe kontrollet e pershtatshme, dhe per te monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit te riskut rishikohen rregullisht per te reflektuar ndryshimet ne kushtet e tregut dhe ne aktivitetet e Shoqerise. Shoqeria, permes trajnimeve dhe

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 5 Manaxhimin i riskut financiar (vazhdim)

standardeve dhe procedurave te menaxhimit, synon te zhvilloje nje ambient kontrolli konstruktiv dhe te disiplinuar ne te cilin gjithë punonjesis i kuptojne rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet financiare kryesore te Shoqerise konsistojne ne vlerat ne arke dhe ne banka. llogarite e arketueshme dhe te pagueshme dhe detyrime te tjera afatshkurtra.

#### *Paqendrueshmeria ne tregun financiar nderkombetar dhe shqiptar*

Kriza aktuale financiare dhe ekonomike ka rezultuar, ndermjet te tjerave, ne nje nivel me te ulet te financimit te tregut te kapitalit, nivele me te ulta likuiditeti permes sektorit bankar, dhe ndonjehere, ne interesa huadhenie nderbankare me te larta dhe paqendrueshmeri ne tregjet e aksioneve. Pasigurite ne tregjet financiare nderkombetare kane çuar gjithashtu ne falimentime bankash dhe shpetimin e tyre kudo ne bote. Shtrirja e plote e ndikimit te krizes financiare aktuale tregon se eshte e pamundur te parashikohet apo te mbrohet plotesisht prej saj.

#### *Ndikimi ne likuiditet*

Volumi i financimit nga shitesit e shumices ka rene ndjeshem kohet e fundit. Rrethana te tilla mund te ndikojne mundesine e Shoqerise per te marre hua te reja, nese do te jete e nevojshme, dhe te ri-financoje huate ekzistuese me kushte dhe afate te ngjashme me ato te aplikuar me pare.

#### *Ndikimi ne klientet/huamarresit*

Debitorët e Shoqerise mund te ndikohen nga situata e likuiditetit te ulet i cili mund te ndikojte aftesine e tyre per ripagimin e shumave qe detyrohen. Perkeqesimet e kushteve shfrytezuese per klientet mund te ndikojne gjithashtu parashikimet e fluseve monetare nga drejtimi dhe vleresimin e zhvleresimit te aktiveve financiare dhe jo-financiare. Deri ne ate mase qe informacioni eshte i disponueshem, drejtimi ka reflektuar siç duhet vleresime te korrigjuara te flukseve monetare te pritshme ne vleresimet e zhvleresimit.

#### *(i) Risku i kredise*

Risku i mos-pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arkëtueshme. Maksimumi i riskut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Risku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve. Shoqëria e vlerëson cilësinë e llogarive të arkëtueshme që nuk janë me vonesë dhe as të zhvlerësuar si shumë të kënaqshme.

#### *(ii) Risku i likuiditetit*

Shoqëria duhet te permbushe nevojat per mjete monetare, kryesisht per kostot e shfrytezimit qe rrjedhin nga aktivitetet e publicitetit. Ekziston rreziku qe mjetet monetare mund te mos jene te disponueshme per te shlyer detyrimet ne kohen e duhur me nje kosto te arsyeshme. Shoqëria monitoron likuiditetin ne baza periodike ne menyre qe te menaxhoje detyrimet e saj kur ato kerkohen.

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 5 Manaxhimin i riskut financiar (vazhdim)

#### (iii) Risku i tregut

*Risku i normave te interesit*

Shoqeria nuk disponon instrumente financiare me interes me 31 Dhjetor 2013 dhe 2012.

*Risku i kursit te kembimit*

Shoqeria ndermerr transaksione ne Lek, Euro dhe USD. Risku i pozicionit valutor menaxhohet nepermjet parimit te perputhjes se aktiveve me detyrimet. Shoqeria nuk ka hyre ne ndonje marreveshje derivative per kontrata te ardhshme shkembimi me 31 Dhjetor 2013 dhe 2012.

*Analiza e ndjeshmerise*

Me anen e menaxhimit te riskut te normave te interesit dhe te pozicionit valutor. Shoqeria synon te reduktoje ndikimin e luhatjeve afatshkurtra ne fitimet e Shoqerise. Ne nje periudhe afatgjate, sidoqofte, ndryshimet e perhershme ne kurset e kembimit dhe normat e interesit mund te kene nje ndikim ne fitim. Me 31 Dhjetor 2013 Shoqeria nuk disponon instrumente financiare me interes.

#### (iv) Manaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqerise eshte te mbaje nje baze te forte kapitali ne menyre qe te ruaje besueshmerine e investitoreve dhe kreditoreve dhe te mbeshtese zhvillimin e metejshem te biznesit. Bordi i Drejtoreve monitoron kthimet nga kapitali. te cilat Shoqeria i percakton si te ardhura neto te shfrytezimit ndaj totalit te kapitalit.

Shoqeria nuk eshte subjekt i kerkesave te kapitalit te vendosura nga ente rregullatore.

### 6 Aktive afatgjata materiale

Aktivete afatgjata materiale perbehen nga sa me poshte:

	Pajisje informatike	Pajisje zyre	Te tjera	Totali
<b>Kosto</b>				
Me 01 Janar 2012	1.644.956	1.240.223	592.801	3.477.980
Shtesa	33.600	-	-	33.600
<b>Me 31 Dhjetor 2012</b>	<b>1.678.556</b>	<b>1.240.223</b>	<b>592.801</b>	<b>3.511.580</b>
Shtesa	343.673	-	-	343.673
<b>Me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>2.022.229</b>	<b>1.240.223</b>	<b>592.801</b>	<b>3.855.253</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>				
Me 01 Janar 2012	(296.939)	(162.929)	(61.458)	(521.326)
Amortizimi per vitin	(338.405)	(215.459)	(106.270)	(660.134)
<b>Me 31 Dhjetor 2012</b>	<b>(635.344)</b>	<b>(378.388)</b>	<b>(167.728)</b>	<b>(1.181.460)</b>
Amortizimi per vitin	(285.091)	(172.368)	(85.016)	(542.475)
<b>Me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>(920.435)</b>	<b>(550.756)</b>	<b>(252.744)</b>	<b>(1.723.935)</b>
<b>Vlera kontabel neto:</b>				
Me 01 Janar 2012	1.348.017	1.077.294	531.343	2.956.654
Me 31 Dhjetor 2012	1.043.212	861.835	425.073	2.330.120
Me 31 Dhjetor 2013	1.101.794	689.468	340.057	2.131.318



# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 7 Kliente dhe te tjera kerkesa per arketim

Kerkesa per arketim perbehet si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Kerkesa per arketim	182.130.812	161.560.058
Te ardhura te perllogaritura	19.280.607	13.023.123
Te tjera te arketueshme	282.584	2.086.858
<b>Totali</b>	<b>201.694.003</b>	<b>176.670.039</b>

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kredisë dhe pozicionit valutor si dhe humbjet nga zhvlerësimi lidhur me kërkesat për arkëtim janë të paraqitura në shënimin 18.

### 8 Parapagimet dhe te ardhurat e shtyra

Gjate vitit 2013 Shoqëria ka patur nje marreveshje me Vodafone Albania per ofrimin e sherbimeve publicitare. Sipas kesaj marreveshje, Vodafone Albania ka bere parapagim per sherbim mediatik gjate vitit 2013 ne shumen prej 40.285.440 Lek (2012: 44.739.200 Lek). Ne rolin e nje agjenti ndermjetes, Shoqëria ka parapaguar te njejten shume furnitorit Unlimited Media Shpk. Parapagimet jane njohur ne fitim humbje si e ardhur dhe kosto gjate vitit ushtrimor ne perputhje me periudhen keto sherbime jane ofruar dhe me 31 Dhjetor 2013 pjesa e mbetur qe i takon periudhes pas dates 1 Janar 2014 eshte njohur si parapagim ndaj furnitoreve dhe te ardhura te shtyra per shumen 12.309.440 Lek (2012: prej 13.701.380 Lek).


### 9 Mjete Monetare dhe ekuivalente me to:

Mjete monetare dhe ekuivalente me to perbehet si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Vlera në arkë	152.403	89.966
Vlera në banka	12.292.112	21.923.026
Ne Lek	11.336.654	21.498.536
Ne Euro	955.458	424.490
<b>Totali</b>	<b>12.444.515</b>	<b>22.012.992</b>

### 10 Kapitali aksioner

Kapitali i paguar me 31 Dhjetor 2013 eshte 3.500.000 Lek i ndare ne 3.500 aksione te zakonshme me vlere nominale 1.000 Lek secili. Kapitali aksionar i nenshkruar eshte paguar plotesisht.

 13

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 11 Furnitore dhe detyrime te tjera

Furnitore dhe detyrime te tjera perbehen nga sa me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Furnitoret	182.622.127	181.705.710
TVSH e pagueshme, neto	5.049.930	1.668.533
Paga te pagueshme	-	14.227
Taksa dhe tatime te tjera	358.897	805.438
Dividende te pagueshem	1.675.384	1.675.383
Detyrime te tjera	22.799.072	12.897.350
<b>Totali</b>	<b>212.505.410</b>	<b>198.766.641</b>

### TVSH e pagueshme, neto

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
TVSH e pagueshme mbartur nga viti paraardhes	1.668.533	6.390.548
TVSH e llogaritur (rubrika 12)	130.001.969	161.738.667
TVSH i zbritshem blerje (rubrika 17)	(101.848.631)	(127.624.946)
TVSH e paguar gjate vitit ushtrimor	(24.771.941)	(38.835.736)
<b>Detyrime tatimore per TVSH</b>	<b>5.049.930</b>	<b>1.668.533</b>

Ne shifren e afarizimit dhe TVSH e llogaritur ne blerje dhe shitje sipas sistemit tatimor eshte perfshire edhe vlera e tatueshme 647.894 Lek (2012: 995.499 Lek) per autofaturimet sipas nenit 15, pika 5 te ligjit 7928 per "Tatimin mbli Vleren e Shtuar" e cila nuk perfaqeson nje te ardhur per shoqerine. Gjithashtu, ne sistemin tatimor per vitin 2013 perfshihet dhe detyrimi per TVSH sipas Akt Kontrollit i dates 27/01/2014 ne shumen 49.963 Lek (2012: 115.110 Lek).

### 12 Te ardhurat

Te ardhurat nga aktiviteti perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Media outdoor	103.087.050	128.790.764
Komisione	24.858.235	26.827.508
Media televizive	428.350.147	533.178.742
Media radio	18.226.430	37.791.091
Media kinema	-	6.925.000
Media internet	25.969.488	15.856.815
Media print	30.211.068	36.825.138
Monitorim	1.426.561	997.182
Sherbim PR	4.038.044	4.847.436
Produksion	20.755.316	17.136.171
<b>Totali</b>	<b>656.922.339</b>	<b>809.175.847</b>

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 13 Kosto per kryerjen e sherbimeve

Kosto per kryerjen e sherbimeve sipas aktivitetit perbehen nga sa me poshte:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Media outdoor	102.686.427	128.086.416
Media televizive	426.905.693	529.304.375
Media radio	17.655.192	35.746.481
Media kinema		6.925.000
Media internet	25.803.406	15.856.862
Media print	29.603.702	36.281.999
Monitorimi	1.383.929	686.788
Sherbim PR	3.947.864	4.805.076
Produksion	19.245.375	17.031.917
<b>Totali</b>	<b>627.231.588</b>	<b>774.724.914</b>

### 14 Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Pagat	21.398.503	20.209.121
Sigurimet shoqerore	1.258.608	966.979
<b>Totali</b>	<b>22.657.111</b>	<b>21.176.100</b>

### 15 Shpenzimet te pergjithshme dhe administrative

Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative jane te analizuara si me poshte:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Qira	2.217.020	2.171.221
Sherbime profesionale	1.114.137	1.042.940
Udhetime dhe dieta	45.528	-
Trajnim	-	-
Uje, drita, telefon	84.000	-
Postare dhe komunikimi	732.644	834.839
Gjoha dhe demshperblime	-	2.446.124
Shpenzime per dhurata	17.251	224.800
Shpenzime bankare	198.366	96.928
Shpenzime te tjera operative	588.913	4.449.079
<b>Totali</b>	<b>4.997.859</b>	<b>11.265.931</b>

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 16 Te ardhura te tjera

Shoqeria ka apeluar aktin administrativ Njoftim Vleresimit Tatimor per Detyrimet, nr. 2581/4 prot. Date 30/05/2012 nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve te Medhenj. Vendimi nga Drejtoria e Apelimit Tatimor ne lidhje me kete apelime ka qene shfuqizimi i aktit administrativ per detyrimin tatimor per TVSH per vitin 2011, dhe ne sistemin tatimor eshte njohur si gjendje kreditore TVSH shuma 1.578.736 Lek. Gjate vitit 2012 shoqeria ka njohur si te ardhura ne lidhje me kete vendim shumen 1.429.953 Lek, dhe rrjedhimisht diferenca prej 148.783 Lek eshte njohur si e ardhur per vitin 2013.

### 17 Tatimi mbi fitimin

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Tatimi aktual	162.927	425.881
Tatimi i shtyre	-	-
<b>Totali</b>	<b>162.927</b>	<b>425.881</b>

Tatimi mbi fitimin ne Shqiperi vleresohet ne normen 10% te fitimit te tatueshem (2012:10%). Me poshte paraqitet nje rakordim i tatimit mbi fitimin te llogaritur me normen e takses se aplikueshme me shpenzimin e tatimit mbi fitimin

	Norma efektive e tatimit	31 Dhjetor 2013	Norma efektive e tatimit	31 Dhjetor 2012
Fitimi para tatimit		1.632.775		1.587.887
Tatimi fillestar me 10%	10%	163.278	10.00%	158.789
Anullimi i diferencave te perkohshme njohur ne vitin paraardhes				
Efekti tatimor i shpenzimeve qe nuk jane te zbritshme per qellime tatimore	-	(14.528)	16.82%	267.092
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>10%</b>	<b>162.927</b>	<b>26,82%</b>	<b>425.881</b>

Me poshte paraqitet nje rakordim i fitimit ne perputhje me Standartet kombetare te kontabilitetit dhe fitimit te tatueshem:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Fitimi para tatimit	1.632.775	1.587.887
Te ardhura te patatueshme	(148.783)	
Shpenzime te pa-zbritshme	145.280	2.670.924
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>1.629.272</b>	<b>4.258.811</b>

 16

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 18 Instrumentat Financiare

#### Ekspozimi ndaj riskut te kredise

Vlera kontabel e aktiveve financiare perfaqeson ekspozimin maksimal ndaj riskut te kredise. Ekspozimi maksimal ndaj riskut te kredise ne ditën e raportimit ishte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Kerkesa tregtare per arketim	201.694.003	176.670.039
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12.444.515	22.012.992
	<b>214.138.518</b>	<b>198.683.031</b>

#### Humbje nga Zhvleresimi

Analiza sipas vjetersise e kerkesave tregtare per arketim ne datën e raportimit eshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Te pa vonuara	83.521.065	57.900.206
Me shume se 30 dhe me pak se 60 dite	3.488.234	5.217.041
Me shume se 60 dhe me pak se 90 dite	174.887	8.737.821
Me shume se 90 dhe me pak se 120 dite	2.003.408	332.020
Me shume se 120 dhe me pak se 360 dite	10.634.983	20.635.696
Me shume se 360 dite	82.308.235	68.737.274
	<b>182.130.812</b>	<b>161.560.058</b>
Provizione per zhvleresim	-	-
<b>Gjendje ne fund te vitit</b>	<b>182.130.812</b>	<b>161.560.058</b>

Shoqeria beson se nuk eshte i nevojshem ndonje provizion per zhvleresim ne lidhje me kerkesat tregtare per arketim te cilat nuk jane te vonuara.

#### Ekspozimi ndaj riskut te likuiditetit

Me poshte paraqiten aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit te mbetur me 31 Dhjetor 2013 dhe 2012:

	31 Dhjetor 2013				
	Deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Kerkesa tregtare per arketim	201.694.003				201.694.003
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12.444.515				12.444.515
Furnitore dhe detyrime te tjera	(212.505.410)				(212.505.410)
<b>Risku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1.633.108</b>	-	-	-	<b>1.633.108</b>

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 18 Instrumentat Financiare (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj riskut te likuiditetit (vazhdim)

	31 Dhjetor 2012				
	Deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Kerkesa tregtare per arketim	176.670.039				176.670.039
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	22.012.992				22.012.992
Furnitore dhe detyrime te tjera	(198.766.641)				(198.766.641)
<b>Risku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2012</b>	<b>(83.610)</b>	-	-	-	<b>(83.610)</b>

#### Ekspozimi ndaj riskut te pozicionit valutor

Ekspozimi Shoqerise ndaj riskut te pozicionit valutor ne 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 ishte si me poshte:

	31 December 2013			
	EUR	LEK	Total	
Kerkesa tregtare per arketim	2.255.811	199.438.192	201.694.003	
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	1.025.768	11.418.748	12.444.516	
Furnitore dhe detyrime te tjera	197.242	212.308.168	212.505.410	
<b>Pozicioni valutor me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>3.478.821</b>	<b>423.165.108</b>	<b>426.643.929</b>	

	31 December 2012			
	EUR	LEK	Total	
Kerkesa tregtare per arketim	666.639	176.003.400	176.670.039	
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	494.493	21.518.499	22.012.992	
Furnitore dhe detyrime te tjera	(572.877)	(198.193.764)	(198.766.641)	
<b>Pozicioni valutor me 31 Dhjetor 2012</b>	<b>588.255</b>	<b>(671.865)</b>	<b>(83.610)</b>	

Kursi i kembimit per Lekun ne fund te periudhes se raportimit ishte si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
USD 1	101,86	105,85
EUR 1	140,20	139,59

 18

# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 18 Instrumentat Financiare (vazhdim)

#### Analiza e ndjeshmerise

Nje forcim prej 10% i Lekut ndaj Euros ne 31 Dhjetor 2013 do te rriste/(ulte) kapitalet e veta dhe fitime ose humbjet me vlerat e treguara me poshte. Kjo analize presupozon qe te gjithe indikatorret e tjere. ne vecanti normat e interesit. te jete te pandryshuara. E njejta analize eshte bere edhe per vitin 2012.

	Kapitalet e veta	Fitime/(humbje) neto
<b>2013</b>		
EUR	347.882	347.882
<b>2012</b>		
EUR	58.826	58.826

Nje dobesim prej 10% i Lekut ndaj Euros ne 31 Dhjetor 2013 do te kishte nje ndikim te njejte ne vlere por ne krahun e kundert, duke presupozuar qe te gjithe indikatorret e tjere do te jene te pandryshuar.

#### Ekspozimi ndaj riskut te normes se interesit


Ne daten e raportimit Shoqeria nuk disponon instrumenta financiare me interes.

### 19 Palet e lidhura

Palet jane te konsideruara te lidhura kur nje nga palet ka aftesine per te kontrolluar ose te ushtroje influence te mjaftueshme mbi palen tjetere ne marrjen e vendimeve financiare apo operacionale. ose palet jane nen kontroll te perbashket me Shoqerine.

Palet e lidhura perfshijne:

- DDB Albania Sh.A. e cila zoteron 67% (2012:67%) te kapitalit aksionar te Shoqerise.
- Grupi i kompanive te Omnicom Group Inc.
- Znj.Vilma Maze e cila zoteron 33% te kapitalit aksionar te Shoqerise (2012: 33%) dhe mban pozicionin Administratore e Shoqerise me 31 Dhjetor 2013 (2012: Znj. Vilma Maze)
- Nje numer transaksionesh jane zhvilluar me palet e lidhura ne kursin normal te biznesit. Volumi i ketyre transaksioneve dhe vlerat e mbartura ne fund te periudhave raportuese jane si me poshte:



# Optimum Media Sh.A

## Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(Vlerat ne Lek)

### 19 Palet e lidhura (vazhdim)

	31 Dhjetor	
	2013	2012
Kerkesa per arketim nga DDB Albania Sh.a.	6.658.224	6.680.761
Kerkesa te tjera per arketim nga Omnicom Financial Services LTD		
<b>Totali i kerkesave per arketim nga palet e lidhura</b>	<b>6.658.224</b>	<b>6.680.761</b>
Te pagueshme ndaj DDB Albania Sh.a.		-
Dividend te pagueshem ndaj DDB Albania Sh.a.	-	1.160.813
<b>Totali i detyrimeve ndaj paleve te lidhura</b>	<b>-</b>	<b>1.160.813</b>
Te ardhura nga DDB Albania Sh.a.	1.185.065	1.460.374
<b>Totali i te ardhurave nga palet e lidhura</b>	<b>1.185.065</b>	<b>1.460.374</b>
Totali i shpenzimeve te pergjithshme te faturuara nga Olympic DDB S.A		
Totali i shpenzimeve te pergjithshme te faturuara nga DDB Albania Sh.A		-
<b>Totali i shpenzimeve te pergjithshme te faturuara nga palet e lidhura</b>		<b>-</b>
Totali i shpenzimeve te faturuara ndaj Omnicom Financial Services LTD		-
<b>Total i shpenzimeve te faturuara ndaj paleve te lidhura</b>		<b>-</b>
Shpenzime per perfitimet e drejtuesve	7.633.491	8.127.297

### Angazhime dhe detyrime te kushtezura

#### Angazhime per qirane e zakonshme

Ne 31 Dhjetor 2013 Shoqeria ishte pale ne nje marreveshjeje qiraje te zakoshme per zyrat. Pagesat e ardhme minimale sipas marreveshjes brenda nje viti jane 1.682.400 Lek (2011: 1.675.080 Lek) dhe me shume se nje por me pak se pese vite jane 5.748.200Lek (2012: 418.770 Lek).

Nuk ka angazhime dhe detyrime te tjera te kushtezuara ne 31 Dhjetor 2013.

### 20 Ngjarjet pas dates te raportimit

Nuk ka ngjarje te rendesishme pas dates se raportimit qe do te ishte e nevojshme te te paraqiteshin si rregullime ose informacione shtese ne keto pasqyra financiare.

 20